



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË**

ZYRA PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MEDIAN

Rr. Jordan Misja, Blv Zhan d'Ark, Tiranë, adresë web: www.gjykata.gov.al

Datë 04.02.2026

NJOFTIM PËR SHTYP

Referuar interesit të shfaqur nga disa gazetarë, komunikohet informacioni zyrtar në vijim:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma Penale, mori në shqyrtim kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për Vleftësimin e arrestit dhe Caktimin e masës së sigurimit ndaj personave nën hetim G.N., R.R., A.Ç., dhe K.C..

Gjykata, me vendimin e saj, të arsyetuar në mënyrë të përmbledhur, ditën e sotme, pasi ka dëgjuar palët e pranishme në seancë, si dhe ka shqyrtuar të gjitha faktet, të dhënat, shpjegimet, qëndrimet, si dhe provat e paraqitura nga palët, në bazë dhe për zbatim të nenit 244, 228, 229, 230, 238 të Kodit të Procedurës Penale:

V E N D O S I:

1. Vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë ndaj të dyshuarit G. N., të kryer në datë 01.02.2026, ora 03.00.
2. Të caktojë ndaj shtetasit të dyshuar G. N. si masë të sigurimit personal “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, si i dyshuar për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/6 dhe 25 i K.Penal.
3. Vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë ndaj të dyshuarit R. R. i, të kryer në datë 01.02.2026, ora 01.40.

4. Të caktojë ndaj shtetasit të dyshuar R. R. si masë të sigurimit personal “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, si i dyshuar për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/6 dhe 25 i K.Penal.
5. Vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë ndaj të dyshuarit A. Ç., të kryer në datë 01.02.2026, ora 01.30.
6. Të caktojë ndaj shtetasit të dyshuar A. Ç. si masë të sigurimit personal “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, si i dyshuar për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/6 dhe 25 i K.Penal, “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta” parashikuar nga Neni 279 i K.Penal dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive” parashikuar nga neni 280 i K.Penal.
7. Vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë ndaj të dyshuarit K. Ç., të kryer në datë 01.02.2026, ora 00.59.
8. Të caktojë ndaj shtetasit të dyshuar K. Ç. si masë të sigurimit personal “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, si i dyshuar për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/6 dhe 25 i K.Penal, “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta” parashikuar nga Neni 279 i K.Penal dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive” parashikuar nga neni 280 i K.Penal.
9. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit të arsyetuar.
- U shpall në Tiranë, sot, në datë 03.02.2026.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

e-mail: ola.ismaili@gjykata.gov.al